



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 18.**

Prishtinë, më 29.09.2011 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi

Munguan: Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja **Lejla Selimi**, përfaqësuesit nga KDI-Besnik Ramadani, përfaqësuesi i KKK-Veton Berisha, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës, me raportin e Komisionit funksionale për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. Nr 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-21 për Akcizën në Produktet e Duhanit, me raportin e Komisionit funksionale për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit nr 04/665/L-41/1, me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.
7. Shqyrtimi i Draft propozim planit lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës.
8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
9. Të ndryshme

***Kryesuesi** - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Agim Kuleta – propozoi që pika 8. e rendit të ditës të shtyhet për një kohë të pacaktuar. Me theks të veçantë tha se Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, është kthyer në komision para kohe sepse Kuvendi nuk ka paraparë afat të caktuar. Konsideron se ende nuk është bërë fuqizimi i ndryshimeve Kushtetuese të Republikës së Kosovës andaj Komisioni nuk mund të dal me raport përfundimtar, sepse Kuvendi të njëjtin do ta kthej për rishqyrtim.

Lumnije Morina – tha se në bazë të diskutimeve të dhëna në këtë takim nuk mjaftojnë arsyet që të shtyhet shqyrtimi i Projektligjit, por mendon se komisioni duhet ta procedojë në shqyrtim të mëtejshëm. Konsideron se amendamentet e propozuara nga ana e saj nuk prekin interesat e komuniteteve dhe se të njëjtat nuk bien ne ndesh me Kushtetutshmërinë.

Kryesuesi- theksoi se projektligji nga aspekti juridik nuk prek çështjet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dha sqarim se nga mbledhja e Seancës Plenare, Kuvendi ka nxjerr vendimin për afat shtesë në periudhë prej një muaji dhe si komision FunkSIONAL duhet ti rishqyrtojmë amendamentet e propozuara në këtë Projektligj.

***Kryesuesi** - konstatoi se rendi i ditës u miratua me shumicë të votave dhe një kundër.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

***Kryesuesi** – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 16.09.2011, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës, me raportin e Komisionit funksionale për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin **04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës**, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit FunkSIONAL.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. Nr 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në **për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. Nr 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. Nr 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-21 për Akcizën në Produktet e Duhanit, me raportin e Komisionit funksionale për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin **nr. 04/L-21 për Akcizën në Produktet e Duhanit**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **nr. 04/L-21 për Akcizën në Produktet e Duhanit** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit nr 04/665/L-41/1, me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin **për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit nr 04/665/L-41/1**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit nr 04/665/L-41/1** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Draft propozim planit lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te komuniteteve dhe pjesëtareve te tyre ne Republikën e Kosovës.

Kryesuesi – me theks të veçantë tha se secili anëtarë i komisionit duhet të kontribuoj në plotësimin dhe ndryshimin e draft planit për monitorimin e zbatimit të ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te komuniteteve dhe pjesëtareve te tyre ne Republikën e Kosovës.

Ai propozoi që të formohet grupi punues, i cili do të shqyrtoj me përpikëri pesë fazat e paraqitura në draft propozim, ku hartim i planit final do të miratohet nga ana e komisionit.

Albert Kinolli – pajtohet që të formohet grupi punues, i cili draft do të plotësohet me ndryshimet e duhura dhe se komisioni të ketë një draft sa më të mirë dhe funksional.

Ai diskutoi lidhur me çështjen e ndërtesës e cila është kallur para një viti në komunën e Kastriotit e cila deri sot ka mbet e pabanueshme. Më së shumti kanë pësuar komuniteti ashkali, egjiptian dhe ai rom. Për këtë neglizhencë përgjegjëse është zyra për çështje të komuniteteve, kryetari i komunës së Kastriotit dhe ministrinë përkatëse siç janë MKK dhe MPMS.

Shumë më herët komisioni ka miratuar një marrëveshje me shkrim, e cila deri sot nuk është realizuar:

Ai propozoi që në periudhën sa më të shpejt, komisioni të ftojë përfaqësuesit kompetent nga MKK dhe MPMS, me kontekst që të merret përgjigje konkrete lidhur me fatin e objektit në Kastriot.

Etem Arifi –veçoi se ky komision është i përfaqësuar nga anëtarët e të gjitha komuniteteve, me pas theksoi se në grupin punues duhet të zgjidhet nga një anëtar i cili përfaqëson komunitetin e vet dhe në periudhën sa më të shkurtë të caktohen prioritetet lidhur me monitorimin e ligjit.

Jelena Bontic - ajo propozoi që komisioni saktësisht të caktojë afatet periodike për vizitat që do të bëhen në pesë komunat.

Pas diskutimeve të shumta lidhur me Draft propozimin e planit për monitorimin e zbatimit të ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te komuniteteve dhe pjesëtareve te tyre ne Republikën e Kosovës, Komisioni emëroi grupin punues, në cilësinë e kryesuesit: Elmi Reçica, ndërsa anëtarë tjerë: Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Kryesuesi me vet iniciativë kërkoi që në mungesë të anëtarit Petar Miletic, do të marr pjesë në takimin e grupit punues.

Mbledhja e takimit të parë të grupit punues, do të mbahet me datën 3.10.2001 në ora 11.00.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,

Kryesuesi –tha se në nenet e radhitura në këtë Projektligji janë të përfshira komunitetet të cilat përkufizohen si grupe kombëtare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës

Pjesëtarët të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë Projektligj, andaj propozoi që i njëjti të procedohet në procedurë të mëtejme.

Në bazë të nenit 12, paragrafi 6 të Projektligjit, në Këshillin Konsultativ janë emëruar edhe përfaqësuesit e komuniteti malazez dhe atij kroat.

Ai dha sqarim se në bazë të konsultimeve me përfaqësuesit e Qeverisë dhe përfaqësuesit e ICO-së, propozimet e amendamenteve të dhëna në raport duhet ndryshuar dhe plotësuar.

Lumnije Morina – tha se ligji për promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës ka ardhur nga Qeveria me plotësim dhe ndryshim që në Këshill Konsultativ të hyjnë edhe përfaqësuesit e komunitetit kroat dhe atij malazez.

Ajo konstatoi se dy propozim amendamentet e saja, duhet komisioni ti miratojë dhe më pas të inkorporohen në Projektligj.

Dha sqarim lidhur me propozim amendamente e saja, se Këshilli Konsultativ për Komunitete do të përfaqësohet edhe nga komuniteti malazez dhe ai kroat, në momentin e ndryshimit të Nenit 64, paragrafi 2. (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me ç'rast këto dy komunitete do ti fitojnë kompetencat e tyre si përfaqësues. dhe më pas Projektligji të procedohet për Seancë Plenare.

Elmi Reçica – Në radhë të parë si komision duhet të jemi unik brenda kompetencave të saja dhe veprimet e ndërmerrura duhet të jenë konkrete.

Ai vlerësoi se dispozitat e Projektligjit me amendamentet e propozuara plotësojnë Kornizën Ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve të cilët jetojnë në territorin e Kosovës. Konsideron se komisioni duhet ta votojë Projektligjin për procedim në Kuvend.

Sa i përket të dhënave nga kryesuesi i komisionit se ekspertët ligjor interpretojnë ligjshmërinë, ai propozoi që për realizimin e qëllimit të Projektligjit, vërejtjet e tyre paraprake të njëjtë ti ofrojnë edhe para Komisionit.

Duke pasur parasysh faktin se Komisioni për ndryshime Kushtetuese është në përfundim të punës së tij, dhe se në bazë të neni 64 pika 2, do të përfshihen edhe komuniteti malazez dhe ai kroat.

Albert Kinolli – në fjalinë e tij tha se kur është fjala për Këshillin Konsultativ për komunitete, në bashkëpunim me znj, Myfera kemi propozuar amendamentin 3. ku fjala ‘mund të jetë’ të zëvendësohet me fjalën ‘duhet të jetë’, njëherit kërkoi që komisioni të njëjtin ta miratojë.

Sa i përket propozimit të znj, Lumnije, në amendamentin 5, mendon se ky amendament në mënyrë direkte prek strukturën e Kuvendit.

Myfera Sinik –plotësisht i përmbahet qëndrimit, se amendamenti 3, është më se i nevojshëm që të inkorporohet në raport përfundimtar në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Njëherit pajtohet me propozimin e znj. Lumnije lidhur me amendamentin 4, ku Këshilli Konsultativ do të përfaqësohet edhe nga komuniteti malazez dhe ai kroat.

Në bazë të konsultimeve të shumta, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe kthim mur qëndrim që mbledhja të shtyhet për një javë dhe u vendos që në takim të ftohet përfaqësuesit nga zyra e Kryeministrit me qëllim të ofrimit të informatave të nevojshme, këshillimit, mendimit dhe sugjerimeve të tyre lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Mbledhja do të mbahet në ditën e hënë, më 10 tetor 2011, prej orës 11:00, në sallën N-302, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic